7. Zhvillimi i vazhduar profesional i mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP.	1. Zbaton fazat e zhvillimit në karrierë si mësimdhënës i AFP-së. 2. Kryen vetvlerësim të vazhduar të veprimtarisë profesionale. 3. Merr fidbek nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për zhvillim të vazhduar profesional (ZHVP) 4. Identifikon nevojat profesionale për ZHVP. 5. Bashkëpunon me Koordinatorin e ZHVP-së. 6. Përgatit planin individual të zhvillimit të vazhduar në bashkëpunim me koordinatorin e ZHVP-së. 7. Zhvillon dhe përditëson aftësitë pedagogjike dhe andragogjike. 8. Zhvillon dhe përditëson aftësitë profesionale në fushën/profilin përkatës. 9. Zhvillon dhe përditëson aftësitë “e buta”. 10. Ndjek kurse dhe trajnime formale kualifikimi dhe rikualifikimi. 11. Ndjek trajnime, seminare, workshop-e, konferenca, vizita studimore, panairë etj. 12. Merr pjesë aktivisht në rrjetet profesionale dhe komunitetet e praktikës. 13. Studion individualisht risitë pedagogjike, andragogjike dhe të profesionit përkatës. 14. Mban kontakte me biznesin për përditësim të njohurive	• Kuadri ligjor dhe institucional për zhvillimin e karrierës së mësimdhënësit të AFP-së. • Procedura e vetvlerësimit të veprimtarisë profesionale të mësimdhënësit të AFP-së. • Mënyrat e marrjes së fidbekut nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për ZHVP • Roli i Koordinatorit të ZHVP-së • Veçoritë e aftësive pedagogjike dhe andragogjike. • Veçoritë e aftësive profesionale në fushën/profilin përkatës. • Veçoritë e aftësive “të buta”. • Rëndësia e kurseve, trajnimeve, seminareve, workshop-eve, konferencave, vizitave studimore, panairëve etj., për ZHVP-në e mësimdhënësve • Roli i rrjeteve profesionale dhe komuniteteve të praktikës për ZHVP-në • Rëndësia e studimit individual për ZHVP-në. • Rëndësia e kontakteve dhe e praktikave (stazheve) me biznesin për përditësim të njohurive dhe shprehive në profesionin përkatës. • Rëndësia e shkëmbimit të përvojave me kolegët për ZHVP-në. • Roli i platformave online, webinar-eve dhe formave të tjera digjitale në funksion të	– Bën vetvlerësimin e vazhduar të veprimtarisë profesionale. – Kryen veprimtari për marrjen e fidbekut nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., për identifikimin e nevojave për ZHVP – Përgatit planin individual të ZHVP-së. – Zhvillon dhe përditëson aftësitë pedagogjike, andragogjike, profesionale dhe aftësitë “e buta”. – Merr pjesë në veprimtari formale, joformale dhe informale për ZHVP-në. – Përdor rrjetet profesionale dhe komunitetet e praktikës për ZHVP-në – Studion individualisht risitë pedagogjike, andragogjike dhe të profesionit. – Praktikohet në bisnese për zhvillimin e kompetencave profesionale. – Kryen veprimtari për shkëmbim përvojë me kolegët. – Përdor platformat online, webinar-et dhe format e tjera digjitale në funksion të ZHVP-së. – Zbaton qasje të reja të të nxënësve në mjedise fizike, digjitale dhe të kombinuara (<i>blended</i>).	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të përshkruajë dhe zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional për zhvillim të karrierës së mësimdhënësit të AFP-së – Të bëjë vetvlerësim të vazhduar të veprimtarisë profesionale. – Të marrë fidbek nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për ZHVP – Të identifikojë nevojat profesionale për ZHVP. – Të bashkëpunojë me Koordinatorin e ZHVP-së. – Të përgatitë çdo vit planin individual të ZHVP-së. – Të zhvillojë dhe përditësojë në mënyrë të vazhduar aftësitë pedagogjike, andragogjike, profesionale dhe aftësitë “e buta”. – Të marrë pjesë aktivisht në kurse formale, joformale dhe informale, kualifikimi dhe rikualifikimi. – Të marrë pjesë aktivisht në trajnime, seminare, workshop-e, konferenca, vizita studimore, panairë etj. – Të marrë pjesë aktivisht në rrjetet profesionale dhe komunitetet e praktikës. – Të studiojë individualisht risitë pedagogjike, andragogjike dhe të profesionit përkatës. – Të krijojë kontakte dhe të kryejë stazhe në biznese për përditësim të njohurive dhe shprehive të profesionit përkatës. – Të kryejë veprimtari shkëmbimi përvojë me kolegët për aspekte të mësimdhënies dhe të profesionit përkatës.

	dhe shprehive të profesionit përkatës. 15. Kryen praktika (stazhe) profesionale në biznese, në profesionin përkatës. 16. Shkëmben përvoja me kolegët për aspekte të mësimdhënies dhe të profesionit përkatës. 17. Merr pjesë aktivisht në projekte zhvillimore. 18. Përdor platforma online në funksion të ZHVP-së. 19. Merr pjesë në <i>webinar</i>-e dhe forma të tjera digjitale shkëmbimi në funksion të ZHVP-së. 20. Eksperimenton dhe zbaton forma dhe metoda të reja të të nxënit në mjedise fizike, digjitale dhe të kombinuara (<i>blended</i>).	ZHVP-së. • Veçoritë e formave dhe metodave të reja të të nxënit në mjedise fizike, digjitale dhe të kombinuara (<i>blended</i>).			- Të marrë pjesë aktivisht në projekte zhvillimore. - Të përdorë platforma online, <i>webinar</i>-e dhe forma të tjera digjitale në funksion të ZHVP-së. - Të zbatojë forma dhe metoda të reja të të nxënit në mjedise fizike, digjitale dhe të kombinuara (<i>blended</i>)
--	--	---	--	--	---

8. Zbatimi i rregullave të sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm	1. Përcakton rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të procesit mësimor 2. Udhëzon nxënësit dhe kursantët për rregullat e sigurisë në procesin mësimor 3. Udhëzon nxënësit dhe kursantët për dhënien e ndihmës së parë 4. Siguron mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale 5. Zbaton masat e sigurisë në mjediset e mësimit teorik dhe praktik 6. Monitoron zbatimin e rregullave dhe manualeve për përdorimin e sigurtë të mjeteve të mësimit praktik	• Rreziqet gjatë realizimit të procesit mësimor dhe shkaqet e tyre • Rregullat e sigurisë gjatë realizimit të procesit mësimor teorik dhe praktik • Procedura e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit • Mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale, si dhe përdorimi i tyre • Rregullat për përdorimin e sigurtë të mjeteve të mësimit praktik • Plani i evakuimit në raste rreziku • Rregullat e shpëtimit dhe të mbrojtjes nga zjarri • Rregullat mjedisore dhe të	- Shmang rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të mësimin - Parapërgatit nxënësit dhe kursantët për rregullat e sigurisë në mësim. - Parapërgatit nxënësit dhe kursantët për dhënien e ndihmës së parë - Garanton përdorimin e mjeteve sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale - Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e masave të sigurisë gjatë mësimin teorik dhe praktik - Praktikon dhënien e ndihmës së parë	- Të jetë korrekt/e - Të jetë bashkëpunues/e - Të jetë i/e kujdesshëm - Të jetë i/e përpiktë - Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	- Të përcaktojë dhe të shmangë rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të procesit mësimor - Të udhëzojë dhe përgatitë nxënësit dhe kursantët për zbatimin e rregullave të sigurisë në procesin mësimor - Të udhëzojë dhe përgatitë nxënësit dhe kursantët për dhënien e ndihmës së parë - Të sigurojë mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale në mjediset mësimore teorike dhe praktike - Të zbatojë masat e sigurisë në mjediset e mësimin teorik e praktik - Të monitorojë zbatimin e rregullave dhe manualeve për përdorimin e sigurtë të mjeteve të mësimin
---	--	---	--	---	--

	7. Jep ndihmën e parë në rast nevojë 8. Zbaton planin e evakuimit në raste rreziku 9. Zbaton rregullat e shpëtimit dhe të mbrojtjes nga zjarri 10. Udhëzon nxënësit dhe kursantët për rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm 11. Organizon grumbullimin dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim 12. Verifikon ndarjen e mbeturinave sipas llojeve 13. Monitoron zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm 14. Zbaton masat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm	zhvillimit të qëndrueshëm • Rëndësia e riciklimit të mbetjeve • Procedura e grumbullimit dhe e hedhjes së mbetjeve në vendet e caktuara • Masat për mbrojtjen e mjedisit dhe për zhvillimin e qëndrueshëm	- Përgatit planin e evakuimit në raste rreziku - Parpërgatit nxënësit dhe kursantët për rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm - Krijon kushte për grumbullimin, ndarjen dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim - Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm		praktik - Të japë ndihmën e parë në rast nevojë - Të përgatitë dhe praktikojë planin e evakuimit në raste rreziku - Të udhëzojë dhe praktikojë nxënësit dhe kursantët për rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm - Të organizojë grumbullimin, ndarjen dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim - Të zbatojë dhe monitorojë zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
--	--	--	---	--	---

(C) Mentorët e biznesit (Kodi 2320.41 LKPⁱ) të angazhuar në AFP të dyfishtë udhëheqin dhe mbështetin nxënësit e arsimit profesional gjatë praktikës në vendin e punës. Me mbështetjen e tyre, nxënësit zhvillojnë shprehitë praktike sipas standardeve të profesionit dhe programit mësimor përkatës. Mentorët monitorojnë performancën e nxënësve, japin udhëzime të vazhdueshme dhe sigurojnë mjedis të sigurt pune. Bashkëpunojnë me shkollën për të përcjellë ecurinë dhe për të ndihmuar në zhvillimin profesional të nxënësve.

Standardi i profesionit për këtë kategori mësimdhënësish përbëhet nga funksionet e mëposhtme:

Funksioni	Përshkrimi i funksionit
1. Planifikimi dhe organizimi i praktikës së nxënësve në biznes.	Planifikimi i praktikës profesionale në biznes duke konsideruar veçoritë e nxënësve, analizën e skeletkurrikulit, kushtet, mjetet dhe proceset teknologjike në biznesin përkatës, si dhe kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatore. Krijimi i mjedisit të sigurt, mbështetës, motivues dhe gjithëpërfshirës për nxënësit, për realizimin me efektivitet të praktikës profesionale në biznes.
2. Drejtimi dhe mbikëqyrja e praktikës së nxënësve në biznes.	Drejtimi i planifikuar i praktikës profesionale në mjediset punuese të biznesit, demonstrimi i shprehive praktike, mbikëqyrja dhe mbështetja e nxënësve gjatë kryerjes së praktikës profesionale në kuadrin e arsimit profesional të dyfishtë.
3. Vlerësimi i nxënësve gjatë praktikës në biznes .	Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit (listave të kontrollit) të shprehive praktike të nxënësve, që lidhen me parimet e vlerësimit dhe me rezultatet e të nxënësve të përcaktuara në programin e praktikës profesionale në biznes, si dhe realizimi i procesit të vlerësimit të sipas kriterëve të përcaktuara te listat e kontrollit dhe veçorive individuale të nxënësve.
4. Krijimi i marrëdhënieve profesionale gjatë praktikës në biznes.	Zhvillimi i marrëdhënieve bashkëpunuese, etike dhe efektive me nxënësit, eprorët, kolegët, mësuesit e shkollës, prindërit e nxënësve dhe aktorët e tjerë të biznesit dhe AFP-së.
5. Zhvillimi i vazhduar profesional i mentorëve të arsimit profesional të dyfishtë.	Pjesëmarrja aktive në veprimtari për zhvillimin e vazhdueshëm profesional, përfshirë dhe studimin individual online, bazuar në kërkesat e profesionit, zhvillimet didaktike dhe analizën e nevojave personale.
6. Zbatimi i rregullave të sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.	Zbatimi me korrektësi i parimeve dhe i rregullave të sigurisë, higjienës, shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në mjediset e realizimit të praktikës profesionale në biznes.

“MENTORË NË AFP TË DYFISHTË”

Funksionet	Detyrat	Njohuritë	Shprehitë	Qëndrimet	Kriteret e përmbushjes
1. Planifikimi dhe organizimi i praktikës së	- Analizon kërkesat ligjore, rregullatore dhe institucionale për AFP të formës së dyfishtë - Analizon kontratat për	- Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për AFP të formës së dyfishtë. - Përmbajtja e kontratës për	- Zbaton kuadrin ligjor dhe rregullator për AFP të formës së dyfishtë - Zbaton rregulloret e	- Të jetë korrekt/e - Të jetë bashkëpunues/e - Të jetë i/e	- Të përshkruajë kuadrin ligjor, rregullator dhe institucional të AFP të formës së dyfishtë - Të zbatojë kontratat dhe rregulloret

nxënësve në biznes.	mësimin e profesionit. - Analizon kërkesat e kualifikimit profesional dhe të kurrikulit përkatës. - Analizon veçoritë, nevojat dhe potencialin e nxënësve. - Përshtat “programin e veprimtarive për mësimin e profesionit” në bashkëpunim me mësimdhënësin përkatës - Përzgjedh metoda aktive, për realizimin e praktikës në biznes. - Përzgjedh instrumente të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve të nxënësve. - Planifikon burimet e nevojshme për realizimin e praktikës së nxënësve. - Planifikon rotacionin e nxënësve në vendet e punës. - Njih nxënësit me stafin, mjediset, rregullat dhe veprimtarinë e biznesit - Informon nxënësit për rregullat dhe programin e veprimtarive praktike. - Informon nxënësit për rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes mjedisore në biznes - Përshtat mjedisin e praktikës në përputhje me programin e veprimtarive. - Përshtat mjedisin e praktikës sipas veçorive individuale të nxënësve, përfshirë dhe të atyre me nevoja të veçanta. - Siguron mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për realizimin e veprimtarive	mësimin e profesionit - Qasjet e reja për mentorimin e nxënësve në biznes. - Kërkesat e kualifikimeve profesionale dhe të kurrikulave të AFP të formës së dyfishtë. - Metodologjia për analizën e nevojave dhe të potencialit të nxënësve. - Struktura e skeletkurrikulave të arsimit profesional të dyfishtë - Struktura e programit të vprimtarive të praktikës profesionale në biznes - Metodologjia e planifikimit të praktikës profesionale në biznes - Veçoritë e metodave aktive të realizimit të praktikës profesionale në biznes. - Veçoritë e metodave dhe instrumenteve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve gjatë praktikave në biznes. - Veçoritë e burimeve mësimore dhe medieve didaktike (përfshirë ato digjitale) për zhvillimin efektiv të praktikës në biznes. - Rëndësia e bashkëpunimit me mësimdhënësit dhe koordinatorët e NJZH së shkollës për programin e praktikës në biznes - Struktura dhe kërkesat e dokumentacionit për praktikën profesionale në biznes	brendshme të biznesit dhe të shkollës. - Integron qasjet e reja të mësimit praktik në planifikimin e praktikës në biznes - Përmbush kërkesat e standardeve të kualifikimeve dhe të kurrikulave të AFP-së së dyfishtë - Integron mësimdhënien me nxënësit në qendër, në planifikimin e praktikës në biznes. - Përgatit programin e veprimtarive të praktikës profesionale në biznes, në bashkëpunim me mësimdhënësin përkatës. - Përgatit planet ditore për praktikën në biznes. - Përzgjedh metoda aktive të mësimit gjatë praktikës në biznes. - Përzgjedhë metoda dhe instrumente të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve. - Planifikon nevojat për organizimin e mjedisit të praktikës në biznes. - Plotëson dokumentet për procesin e praktikës së nxënësve në biznes	kujdesshëm - Të jetë i/e përpiktë - Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur. - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	e brendshme të biznesit dhe të shkollës - Të përshkruajë veçoritë e qasjeve të reja për mësimin praktik në praktikat profesionale në biznes. - Të analizojë dhe përmbushë kërkesat e standardeve të kualifikimeve profesionale dhe të kurrikulave të AFP të dyfishtë. - Të përshkruajë metodologjinë për analizën e nevojave dhe të potencialit të nxënësve. - Të përshtatë programin e veprimtarive të mësimit të profesionit - Të përgatitë planet (ditaret) e praktikës profesionale në biznes. - Të përzgjedhë metoda aktive të realizimit të praktikës në biznes. - Të përzgjedhë metodat dhe instrumentet e përshtatshme për vlerësimin e nxënësve. - Të përcaktojë burimet mësimore dhe mediet didaktike (përfshirë ato digjitale) për zhvillimin efektiv të praktikës profesionale në biznes. - Të argumentojë rëndësinë e bashkëpunimit me mësimdhënësit dhe koordinatorët e NJZH së shkollës për planifikimin e praktikës në biznes - Të plotësojë dokumentacionin që lidhet me praktikën profesionale të nxënësve, në biznes
----------------------------	---	---	--	---	---

	praktike të nxënësve 16. Zbaton rregulloret, standardet dhe kërkesat në lidhje me organizimin e mjedisit të praktikës në biznes. 17. Zbaton kërkesat e sigurisë dhe të zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin e praktikës në biznes.				
2. Drejtimi dhe mbikëqyrja e praktikës së nxënësve në biznes.	1. Analizon dhe përshtat programin e veprimtarive për mësimin e profesionit 2. Krijon kushte për praktikimin e nxënësve, sipas programit, parimeve didaktike dhe veçorive individuale 3. Siguron mjetet, materialet dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e praktikës së nxënësve 4. Merr masa për garantimin e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit 5. Krijon marrëdhënie me stafin e biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve 6. Udhëzon dhe motivon nxënësit për kryerjen e detyrave të praktikës 7. Shpjegon shprehinë praktike që do të mësohen nga nxënësit 8. Demonstron dhe ri-demonstron shprehinë praktike që do të mësohen nga nxënësit 9. Vendos nxënësit në vendet e punës në biznes, për praktikën e mbikëqyrur 10. Mbikëqyr nxënësit gjatë praktikimit fillestar të	• Struktura e programit të veprimtarive për mësimin e profesionit • Kërkesat për praktikimin e nxënësve në biznes • Parimet didaktike për mësimin praktik • Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e praktikës në biznes • Masat për garantimin e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit • Rëndësia e krijimit të marrëdhënieve elektive me stafin e biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve • Qasjet për motivimin e nxënësve për kryerjen e detyrave të punës • Teknikat e shpjegimit të shprehive praktike që do të mësohen nga nxënësit • Teknikat e demonstrimit të shprehive praktike që do të mësohen nga nxënësit • Teknika e “rotacionit” të vendeve të punës gjatë praktikës profesionale në biznes • Kërkesat për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e nxënësve gjatë praktikimit fillestar të shprehive praktike	- Hartimi i programit të përshtatur të veprimtarive për mësimin e profesionit - Pajis mjedisin e praktikës me mjetet dhe materialet për realizimin e praktikës së nxënësve në biznes - Angazhon stafin e biznesit për të mbështetur praktikën e nxënësve - Mbështet nxënësit për kryerjen e detyrave të praktikës - Shpjegon shprehinë praktike që do të mësohen nga nxënësit - Shpjegon dhe demonstroi shprehinë praktike që do të mësohen nga nxënësit - Bën shpërndarjen e nxënësve në vendet e punës në biznes, për praktikën e mbikëqyrur dhe të pavarur - Mbikëqyr nxënësit gjatë praktikimit të shprehive praktike - Drejton veprimtari	- Të jetë korrekt/e - Të jetë bashkëpunues/e - Të jetë i/e kujdesshëm - Të jetë i/e përpiktë - Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur. - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	- Të përshtatë programin e veprimtarive për mësimin e profesionit - Të krijojë kushtet për praktikimin e nxënësve, sipas programit, parimeve didaktike dhe veçorive individuale - Të pajisë mjedisin e praktikës me mjetet, materialet dhe dokumentet e nevojshëm për realizimin e praktikës së nxënësve - Të marrë masa dhe duhura për garantimin e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit - Të mundësojë stafit të biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve - Të udhëzojë dhe motivojë nxënësit për kryerjen e detyrave të praktikës - Të shpjegojë dhe demonstrojë shprehinë praktike që do të mësohen nga nxënësit - Të bëjë shpërndarjen e nxënësve në vendet e punës për kryerjen e praktikave në biznes - Të mbikëqyrë dhe mbështetë individualisht nxënësit gjatë praktikës profesionale në biznes - Të drejtojë veprimtari praktike që zhvillojnë komunikimin me etikë, bashkëpunimin, negociimin, tolerancën dhe zgjidhjen e

	shprehive praktike				
11.	Mbështet individualisht nxënësit gjatë praktikës profesionale të mbikëqyrur	• Kërkesat për praktikën e mbikëqyrur dhe praktikën e pavarur	praktike që zhvillojnë komunikimin me etikë, bashkëpunimin, negociimin, tolerancën dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve.		problemeve të nxënësve.
12.	Vendos nxënësit në vendet e punës në biznes, për praktikë të pavarur	• Qasjet për zhvillimin te nxënësit të komunikimit me etikë, bashkëpunimit, negociimit, tolerancës dhe zgjidhjes së problemeve, gjatë praktikës në biznes.	- Drejton veprimtari praktike që zhvillojnë aftësi drejtuese, planifikuese, organizuese dhe sipërmarrëse të nxënësve.		- Të drejtojnë veprimtari praktike që zhvillojnë aftësi drejtuese, planifikuese, organizuese dhe sipërmarrëse të nxënësve.
13.	Angazhon nxënësit për të kryer praktikë të pavarur		- Drejton veprimtari praktike që zhvillojnë aftësi drejtuese, planifikuese, organizuese dhe sipërmarrëse të nxënësve.		- Të drejtojnë veprimtari praktike që zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve
14.	Mbështet individualisht nxënësit në praktikën e pavarur	• Qasjet për zhvillimin te nxënësit të aftësive drejtuese, planifikuese, organizuese dhe sipërmarrëse gjatë praktikës në biznes.	- Drejton veprimtari praktike që zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve		- Të japë fedback për nxënësit në praktikën profesionale në biznes
15.	Integron veprimtari praktike që zhvillojnë komunikimin me etikë, bashkëpunimin, negociimin, tolerancën dhe zgjidhjen e problemeve të nxënësve.	• Qasjet për zhvillimin te nxënësit të disiplinës dhe korrektësisë gjatë praktikës në biznes	- Jep fedback për ecurinë dhe arritjet e nxënësve në praktikën profesionale në biznes		- Të plotësojnë dokumentacionin për praktikën profesionale të nxënësve në biznes
16.	Integron veprimtari praktike që zhvillojnë aftësi drejtuese, planifikuese, organizuese dhe sipërmarrëse të nxënësve.	• Struktura e dokumentacionit për praktikën profesionale të nxënësve në biznes	- Plotëson formatet e dokumenteve për praktikën profesionale të nxënësve në biznes		- Të koordinojnë angazhimin e stafit të biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve
17.	Integron veprimtari praktike që zhvillojnë disiplinën dhe korrektësinë e nxënësve	• Rëndësia e angazhimit të stafit të biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve	- Mirëmban mjetet e punës gjatë praktikës së nxënësve në biznes		- Të kryejë mirëmbajtjen e mjeteve të punës gjatë praktikës së nxënësve në biznes
18.	Jep fedback për nxënësit në praktikën profesionale në biznes	• Rëndësia e mirëmbajtjes së mjeteve të punës gjatë praktikës së nxënësve në biznes	- Zbaton masat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë praktikës së nxënësve në biznes		- Të zbatojë masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë praktikës së nxënësve në biznes
19.	Plotëson dokumentacionin për praktikën profesionale të nxënësve në biznes	• Rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë praktikës së nxënësve në biznes			
20.	Koordinon angazhimin e stafit të biznesit, që të mbështetin praktikën e nxënësve				
21.	Garanton mirëmbajtjen e mjeteve të punës gjatë praktikës së nxënësve në biznes				
22.	Garanton sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë				

	praktikës së nxënësve në biznes				
3. Vlerësimi i nxënësve gjatë praktikës në biznes.	1. Analizon programin e veprimtarive praktike të nxënësve në biznes.	• Kuptimi, parimet dhe llojet e vlerësimit të nxënësve gjatë praktikës në biznes	– Përcakton objektivat mësimore dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve, bazuar te programi i veprimtarive praktike	– Të jetë korrekt/e	– Të përcaktojë objektivat mësimore të praktikës dhe kriteret e vlerësimit, për nxënësit
	2. Përcakton objektivat mësimore të praktikës dhe kriteret e vlerësimit, për nxënësit.	• Kuadri ligjor, rregullator dhe institucional ku bazohet vlerësimi i nxënësve në AFP të formës së dyfishtë.	– Përgatit lista-kontrolli për vlerësim të shprehive profesionale të nxënësve	– Të jetë bashkëpunues/e	– Të informojë nxënësit për objektivat dhe procedurat e vlerësimit dhe të provimeve
	3. Informon nxënësit për objektivat dhe procedurat e vlerësimit dhe të provimeve.	• Parimet, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve në praktikën profesionale.	– Përgatit lista-kontrolli për vlerësim të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve	– Të jetë i/e kujdesshëm	– Të ndërtojë lista-kontrolli për vlerësimin e shprehive profesionale të nxënësve
	4. Përcakton instrumentet e vlerësimit që do të përdoren.	• Vleftshmëria, besueshmëria, transparenca dhe objektiviteti, si tipare të një vlerësimi të mirë	– Përgatit teste me detyra praktike për nxënësit	– Të jetë i/e përpiktë	– Të përgatitë lista-kontrolli për vlerësimin e qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve
	5. Ndërton lista-kontrolli për vlerësim të shprehive profesionale të nxënësve.	• Llojet dhe veçoritë e instrumenteve të vlerësimit të shprehive praktike të nxënësve	– Kryen vlerësime të procesit dhe të produktit të punës së nxënësve në praktikë	– Të ketë paraqitje korrekte	– Të ndërtojë teste me detyra praktike për nxënësit
	6. Ndërton lista-kontrolli për vlerësim të qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve.	• Struktura dhe veçoritë e listave të kontrollit për vlerësimin e shprehive praktike, si dhe qëndrimeve e vlerave të nxënësve	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të pyetjeve - përgjigjeve	– Të jetë këmbëngulës	– Të vlerësojë procesin dhe produktin e punës së nxënësve në praktikë
	7. Ndërton teste me detyra praktike për nxënësit.	• Struktura dhe veçoritë e testeve me detyra praktike për nxënësit	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të vëzhgimit gjatë praktikës	– Të jetë i/e vendosur.	– Të përdorë pyetje për vlerësimin e njohurive profesionale të nxënësve
	8. Vlerëson procesin e punës së nxënësve në praktikë.	• Veçoritë e vlerësimit të nxënësve me anë të vëzhgimit, fletores së nxënësit, bashkëbisedimit dhe pyetjeve – përgjigjeve.	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të listave të kontrollit	– Të jetë i/e duruar.	– Të vlerësojë nxënësit nëpërmjet vëzhgimit gjatë praktikës
	9. Vlerëson produktin e punës së nxënësve në praktikë.	• Kërkesat dhe rregullat për provimet praktike përfundimtare	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të bashkëbisedimit	– Të jetë krijues.	– Të vlerësojë nxënësit nëpërmjet listave të kontrollit
	10. Përgatit pyetje për vlerësim të njohurive profesionale të nxënësve.	• Rëndësia e dhënies së fdbekut konstruktiv dhe në kohë reale të vlerësimit të nxënësve	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të bashkëbisedimit	– Të jetë empatik/e.	– Të vlerësojë nxënësit nëpërmjet bashkëbisedimit
	11. Vlerëson nxënësit nëpërmjet vëzhgimit gjatë praktikës.	• Rëndësia e interpretimit të të dhënave të vlerësimit të nxënësve	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të bashkëbisedimit		– Të vlerësojë nxënësit nëpërmjet fletores së nxënësit
	12. Vlerëson nxënësit nëpërmjet listave të kontrollit.	• Struktura e dokumentacionit për vlerësimin dhe provimet	– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të bashkëbisedimit		– Të vlerësojë nxënësit në provimet përfundimtare të praktikës profesionale
	13. Vlerëson nxënësit nëpërmjet me bashkëbisedimit.		– Kryen vlerësime të nxënësve në provimet përfundimtare të praktikës profesionale		– Të vlerësojë nxënësit nëpërmjet me fdbekut të marrë nga stafi dhe klientët e biznesit
	14. Vlerëson nxënësit nëpërmjet pyetjeve – përgjigjeve.		– Kryen vlerësime të nxënësve me anë të fdbekut të marrë nga stafi		– Të analizojë rezultatet e vlerësimit për gjykuar mbi procesin e praktikës së nxënësve në biznes
	15. Vlerëson nxënësit nëpërmjet fletores së nxënësit.				– Të komunikojë dhe diskutojë me
	16. Vlerëson nxënësit në				

	provimet përfundimtare të praktikës profesionale. 17. Vlerëson nxënësit nëpërmjet me fidbekut të marrë nga stafi dhe klientët e biznesit. 18. Kryen vlerësime objektive, të vlefshme, të besueshme dhe transparente. 19. Analizon rezultatet e vlerësimit për gjykuar mbi procesin e praktikës së nxënësve në biznes. 20. Komunikon dhe diskuton me nxënësit rezultatet e vlerësimit. 21. Plotëson dokumentacionin për vlerësimin dhe provimet.		dhe klientët e biznesit - Bazohet te rezultatet e vlerësimit për gjykuar mbi procesin e praktikës së nxënësve në biznes - Bashkëbisedon me nxënësit për rezultatet e vlerësimit - Plotëson formatet e dokumenteve për vlerësimin dhe provimet		nxënësit rezultatet e vlerësimit Të plotësojë dokumentacionin për vlerësimin dhe provimet
4. Krijimi i marrëdhënieve profesionale gjatë praktikës në biznes.	1. Mban marrëdhënie etike, bashkëpunuese dhe efektive me drejtuesit, kolegët, mësuesit, prindërit dhe aktorët e tjerë të angazhuar në AFP-në e dyfishtë. 2. Krijon marrëdhënie etike dhe empatie me nxënësit që kryejnë praktikën në biznes 3. Komunikon me etikë dhe me qartësi me nxënësit 4. Respekton normat morale dhe profesionale 5. Trajton me dinjitet dhe drejtësi nxënësit. 6. Respekton individualitetin e nxënësve. 7. Respekton diversitetin gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve. 8. Gjykon dhe vlerëson me drejtësi, objektivitet dhe transparencë. 9. Shmang mbivlerësimin ose	- Tiparet e një mentori të mirë në kuadrin e AFP të dyfishtë - Veçoritë e marrëdhënieve bashkëpunuese, etike dhe efektive të mentorit të AFP të dyfishtë. - Veçoritë e marrëdhënieve etike dhe empatike të mentorit me nxënësit. - Normat morale e profesionale në fushën e mësimdhënies. - Veçoritë e trajtimit me dinjitet dhe drejtësi të nxënësve - Veçoritë e respektimit të individualitetit të nxënësve. - Parimet e respektimit të diversitetit gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve. - Drejtësia, objektiviteti, respekti dhe transparenca në marrëdhënie me nxënësit. - Rëndësia e motivimit dhe e mbështetjes së nxënësve.	- Bashkëpunon dhe komunikon me etikë me eprorët, kolegët dhe aktorët e tjerë të AFP të dyfishtë - Komunikon me etikë me nxënësit. - Vepron në përputhje me normat morale dhe profesionale. - Respekton dinjitetin, diversitetin dhe veçoritë individuale të nxënësve. - Shfaq objektivitet, drejtësi, respekt dhe transparencë me nxënësit. - Motivon dhe mbështet nxënësit - Krijon siguri fizike dhe psikologjike për nxënësit. - Ruan privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve.	- Të jetë korrekt/e - Të jetë bashkëpunues/e - Të jetë i/e kujdesshëm - Të jetë i/e përpiktë - Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur. - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	- Të krijojë marrëdhënie bashkëpunuese, etike dhe efektive me eprorët, kolegët dhe aktorët e tjerë të AFP të formës së dyfishtë. - Të krijojë marrëdhënie respekti, etike dhe empatie me nxënësit - Të komunikojë me etikë dhe me qartësi me nxënësit - Të zbatojë normat morale dhe profesionale gjatë veprimtarisë profesionale - Të trajtojë me dinjitet dhe drejtësi nxënësi. - Të respektojë individualitetin dhe diversitetin gjinor, rracor, fetar, etnik dhe social të nxënësve. - Të bëjë gjykime dhe vlerësime me drejtësi, objektivitet e transparencë - Të motivojë dhe të mbështetë nxënësit. - Të garantojë sigurinë fizike dhe të shmangë frikën, dhunën, tallje apo presionin për nxënësit.

	nënvlerësimin e nxënësve. 10. Krijon marrëdhënie të respektit të ndërsjellë me nxënësit. 11. Motivon dhe mbështet nxënësit. 12. Garanton siguri fizike dhe psikologjike, pa frikë, dhunë, tallje apo presion për nxënësit 13. Garanton privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve. 14. Zgjidh me tolerancë problemet dhe konfliktet në kontekstin profesional. 15. Refuzon favorizimet në kontekstin profesional. 16. Respekton rolet dhe përgjegjësitë profesionale gjatë praktikës së nxënësve në biznes.	• Veçoritë e sigurisë fizike dhe psikologjike për nxënësit. • Rëndësia e garantimit të privatësisë dhe konfidencialitetit të nxënësve. • Roli i tolerancës për zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në kontekstin profesional. • Rëndësia e respektimit të roleve dhe përgjegjësisë profesionale të të angazhuarve në AFP të formës së dyfishtë.	- Tregon tolerancë në zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve në kontekstin profesional. - Bashkëpunon në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë profesionale të të angazhuarve në AFP të formës së dyfishtë.		- Të garantojë privatësinë dhe konfidencialitetin e nxënësve. - Të zgjidhë me tolerancë problemet dhe konfliktet e mundëshme në kontekstin profesional. - Të refuzojë favorizimet e mundëshme në kontekstin profesional. - Të respektojë rolet e përgjegjësitë profesionale të të angazhuarve në AFP të formës së dyfishtë.
5. Zhvillimi i vazhduar profesional i mentorëve të AFP-së së dyfishtë.	1. Zbaton fazat e zhvillimit në karrierë si profesionist dhe si mentor. 2. Kryen vetvlerësim të vazhduar të veprimtarisë profesionale. 3. Merr fedback nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për zhvillim të vazhduar profesional (ZHVP) 4. Identifikon nevojat për ZHVP. 5. Bashkëpunon me përgjegjësit e ZHVP-së në biznes dhe në shkollë. 6. Përgatit planin individual të ZHVP-së. 7. Zhvillon dhe përditëson	• Kuadri ligjor dhe institucional për zhvillimin e karrierës së mentorit në AFP të dyfishtë. • Procedura e vetvlerësimit të veprimtarisë profesionale të mentorit në AFP të dyfishtë . • Mënyrat e marrjes së fedbackut nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për ZHVP • Roli i përgjegjësve për ZHVP në biznes dhe në shkollë • Struktura e planit individual të ZHVP-së së mentorit. • Veçoritë e aftësive pedagogjike dhe profesionale. • Veçoritë e aftësive “të buta”. • Rëndësia e kurseve, trajnimeve, seminareve, workshop-eve,	- Bën vetvlerësimin e vazhduar të veprimtarisë si profesionist dhe si mentor. - Kryen veprimtari për marrjen e fedbackut nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., për identifikimin e nevojave për ZHVP - Përgatit planin individual të ZHVP-së. - Zhvillon dhe përditëson aftësitë pedagogjike, profesionale dhe aftësitë “e buta”. - Merr pjesë në veprimtari për ZHVP-në. - Përdor rrjetet profesionale dhe komunitetet e praktikës për ZHVP-në	- Të jetë korrekt/e - Të jetë bashkëpunues/e - Të jetë i/e kujdesshëm - Të jetë i/e përpiktë - Të komunikojë me etikë profesionale. - Të ketë paraqitje korrekte - Të jetë këmbëngulës - Të jetë i/e vendosur - Të jetë i/e duruar. - Të jetë krijues. - Të jetë empatik/e.	- Të përshkruajë dhe zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional për zhvillim të karrierës së mentorit të AFP të dyfishtë. - Të bëjë vetvlerësim të vazhduar të veprimtarisë profesionale. - Të marrë fedback nga drejtuesit, kolegët, nxënësit etj., në funksion të identifikimit të nevojave për ZHVP - Të identifikojë nevojat për ZHVP. - Të bashkëpunojë me përgjegjësit për ZHVP në biznes dhe në shkollë. - Të përgatitë planin individual të ZHVP-së. - Të zhvillojë dhe përditësojë në mënyrë të vazhduar aftësitë pedagogjike, profesionale dhe aftësitë “e buta”.

	aftësitë pedagogjike dhe profesionale. 8. Zhvillon dhe përditëson aftësitë “e buta”. 9. Ndjek kurse, trajnime, seminare, workshop-e, konferenca, vizita studimore, panaire etj. 10. Merr pjesë aktivisht në rrjetet profesionale dhe komunitet e praktikës. 11. Studion individualisht risitë pedagogjike dhe të profesionit përkatës. 12. Shkëmbejnë përvojë me kolegët dhe mentorët e tjerë 13. Përdor platforma online në funksion të ZHVP-së.	konferencave, vizitave studimore, panaireve etj., për ZHVP-në e mentorëve. • Roli i rrjetëve profesionale dhe komuniteteve të praktikës për ZHVP-në • Rëndësia e studimit individual për ZHVP-në. • Rëndësia e shkëmbimit të përvojave me kolegët dhe mentorët e tjerë për ZHVP-në. • Roli i platformave online në funksion të ZHVP-së.	– Studion individualisht risitë pedagogjike dhe të profesionit. – Kryen veprimtari për shkëmbim përvojë me kolegët dhe mentorët e tjerë. – Përdor platformat online, në funksion të ZHVP-së.		– Të marrë pjesë aktivisht në kurse, trajnime, seminare, workshop-e, konferenca, vizita studimore, panaire etj. – Të marrë pjesë aktivisht në rrjetet profesionale dhe komunitet e praktikës. – Të studiojë individualisht risitë pedagogjike dhe të profesionit përkatës. – Të kryejë veprimtari shkëmbimi përvojë me kolegët dhe mentorët e tjerë – Të përdorë platforma online në funksion të ZHVP-së.
6. Zbatimi i rregullave të sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm	1. Përcakton rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të praktikës në biznes 2. Udhëzon nxënësit për rregullat e sigurisë gjatë realizimit të praktikës në biznes 3. Udhëzon nxënësit për dhënien e ndihmës së parë 4. Siguron mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale 5. Zbaton masat e sigurisë në mjediset e praktikës në biznes 6. Monitoron zbatimin e rregullave dhe manualeve për përdorimin e sigurtë të mjeteve të punës 7. Jep ndihmën e parë në rast nevojë 8. Zbaton planin e evakuimit në raste rreziku 9. Zbaton rregullat e shpëtimit dhe të mbrojtjes nga zjarri	• Rreziqet gjatë realizimit të praktikës në biznes dhe shkaqet e tyre • Rregullat e sigurisë gjatë realizimit të praktikës në biznes • Procedura e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit • Mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale, si dhe përdorimi i tyre • Rregullat për përdorimin e sigurtë të mjeteve të punës • Plani i evakuimit në raste rreziku • Rregullat e shpëtimit dhe të mbrojtjes nga zjarri • Rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm • Rëndësia e riciklimit të mbetjeve • Procedura e grumbullimit dhe e hedhjes së mbetjeve në vendet e caktuara	– Shmang rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të praktikës në biznes – Parapërgatit nxënësit për rregullat e sigurisë gjatë praktikës në biznes. – Parapërgatit nxënësit për dhënien e ndihmës së parë – Garanton përdorimin e mjeteve sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale – Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e masave të sigurisë gjatë praktikës në biznes – Praktikon dhënien e ndihmës së parë – Përgatit planin e evakuimit në raste rreziku – Parapërgatit nxënësit për rregullat mjedisore dhe të	– Të jetë korrekt/e – Të jetë bashkëpunues/e – Të jetë i/e kujdesshëm – Të jetë i/e përpiktë – Të komunikojë me etikë profesionale. – Të ketë paraqitje korrekte – Të jetë këmbëngulës – Të jetë i/e vendosur – Të jetë i/e duruar. – Të jetë krijues. – Të jetë empatik/e.	– Të përcaktojë dhe të shmangë rreziqet e mundëshme gjatë realizimit të praktikës në biznes – Të udhëzojë dhe përgatitë nxënësit për zbatimin e rregullave të sigurisë në procesin mësimor – Të udhëzojë dhe përgatitë nxënësit dhe kursantët për dhënien e ndihmës së parë – Të sigurojë mjetet sinjalizuese dhe të mbrojtjes personale në mjediset e praktikës në biznes – Të zbatojë masat e sigurisë në mjediset e praktikës në biznes – Të monitorojë zbatimin e rregullave dhe manualeve për përdorimin e sigurtë të mjeteve të punës – Të japë ndihmën e parë në rast nevojë – Të përgatitë dhe praktikojë planin e evakuimit në raste rreziku – Të udhëzojë dhe praktikojë nxënësit

	10. Udhëzon nxënësit për rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm 11. Organizon grumbullimin dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim 12. Verifikon ndarjen e mbeturinave sipas llojeve 13. Monitoron zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm gjatë praktikës 14. Zbaton masat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm gjatë praktikës	• Masat për mbrojtjen e mjedisit dhe për zhvillimin e qëndrueshëm	zhvillimit të qëndrueshëm – Krijon kushte për grumbullimin, ndarjen dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim – Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm		për rregullat mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm – Të organizojë grumbullimin, ndarjen dhe hedhjen e mbetjeve në vendet e caktuara për riciklim – Të zbatojë dhe monitorojë zbatimin e rregullave të mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.
--	---	---	---	--	--

Koneksti i profesionit

Për mësimdhënësin e kulturës profesionale në AFP, kohëzgjatja ditore normale e punës përcaktohet nga nenet përkatëse të Kodit të Punës lidhur me kohëzgjatjen e punës dhe pushimeve. Orët e fillimit dhe të mbarimit të punës përcaktohen nga Rregullorja e brendshme e çdo institucioni, brenda kufijve të parashikuara nga ligji, si dhe nga Udhëzimi i MEKI Nr. 759, dt. 30.09.2024 “ Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.

Norma e punës dhe e ngarkesës mësimore të mësimdhënësve të kulturës profesionale në AFP, llogaritet në bazë të Udhëzimit të MFE, Nr. 25, datë 01.09.2023 “Për numrin e nxënësve në klasë dhe normat mësimore në ofruesit e arsimit profesional”,

Mësimdhënësi i kulturës profesionale në AFP duhet të jetë i disponueshëm të punojë me orare të ndryshueshme dhe të zgjatura, sipas rastit.

Mjedisi mësimor	Mjetet mësimore
Klasa/ kabineti	– Tabela shkrime me shkumës. – Tabela shkrimi me markera. – Shkumësa. – Markera me ngjyra. – Pankarta, pamore (postera). – Makete, modele. – Video-projektor. – Tabela flipçarti dhe tabakë të bardhë. – Tabela “pinboard”-i dhe karta shumëngjyrëshe dhe shumëformëshe. – Gjilpëra me kokë. – Letër e bardhë A4. – Letër me ngjyra të ndryshme . – Kompjuter. – Projektor. – Printer. – Fotokopjues. – Skaner. – Lidhje interneti. – CD. – Tekste mësimore. – Materiale mësimore mbështetëse. – Udhëzuesa. – Katalogë.
Repartet e praktikës në shkollë/qendër dhe mjediset reale të punës në biznes	– Makineri për realizimin e praktikës. – Vegla dhe pajisje pune. – Instrumente pune dhe matëse. – Bango/tavolina pune. – Materiale pune/lëndë e parë.
Dokumentacioni shkollor dhe teknik	– Regjistër. – Ditari. – Portofoli i mësimdhënësit. – Kontrata për praktikat profesionale në biznes. – Kontrata për mësimin në AFP të dyfishtë. – Manualët e përdorimit të veglave dhe pajisjeve të punës. – Rregullat e sigurimit teknik në punë. – Lista kontrolli/ udhëzues përmbyshjeje.

	– Test për vlerësimin e njohurive. – Fletorja e nxënësit.
--	--

Kushtet optimale të punës në ofruesit e AFP-së kanë ndriçimin e duhur, temperaturën e duhur të mjedisit gjatë gjithë stinëve, ajrosje të mirë të mjedisit të të nxënit, është e domosdoshme mungesa e lagështisë dhe pluhurave në mjediset e të nxënit.